



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 249, dt. 04.11.2016

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, bazuar dhe në rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit”, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e dates 04.11.2016, pasi shqyrtoi kërkesën për licensim në fushën e restaurimit për *ing. Bledar Mane*,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën për pajisje me licensë restaurimi personale profesionale në fushën e restaurimeve të *ing. Bledar Mane*, për kategorinë **AZ. Zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës, nënkategoria AZ/1 AZ/2 AZ/3 AZ/4**, sipas rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit”.
2. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, pajisjen e *ing. Bledar Mane* me licensë restaurimi personale profesionale në fushën e restaurimeve për kategorinë **AZ. “Zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës”, nënkategoria AZ/1 AZ/2 AZ/3 AZ/4**.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO TURYHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI